



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 37 regjistër (JR)
Datë 05.08.2019

Nr. 38 i vendimit
Datë 17.12.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 17.12.2020, ora 15:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonçi Petković, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 37/2019 (JR), datë 05.08.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i Rivlerësimit Aleksandër Muskaj, ish-gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 179, datë 10.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Aleksandër Muskaj.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6 e vijim; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, nenet 136, 136/1, 136/3, 139 e vijim; ligji ndryshues nr. 76/2016, datë 22.07.2016, nenet 136, 113/5, 139, 139/2, 179/4, 179/b, 179/b/2, 179/b/5, neni G e vijim; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 5, 6, 13, 14, 42, 45, 47, 78, 87, 50, 84 e vijim; ligji nr. 84/2016, nenet 63, 4/6, 47, 3/16, 58/1, 66/1/c e vijim; ligji nr. 49/2012, neni 46 e vijim; ligji nr. 96/2016, nenet 1, 3, 5, 7, 11, 12, 22, 36, 61, 62, 64, 65 e vijim.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në prani të ankuesit, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Aleksandër Muskaj, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Lartë. Për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Aleksandër Muskaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Me vendimin nr. {***}, datë 29.06.2017, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur “Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë për z. Aleksandër Muskaj” dhe në datë 31.07.2017 z. Aleksandër Muskaj ka dorëzuar detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
3. Referuar relacionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. {***} prot., datë 23.04.2019, “Mbi statusin e magjistratit dhe mbarimin e tij për disa ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që iu ka mbaruar mandati”, subjekti i rivlerësimit Aleksandër Muskaj ka depozituar më datë 16.11.2018 pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë një kërkesë me shkrim, përmes së cilës, ndër të tjera, ka deklaruar se heq dorë nga statusi i magjistratit. Në referencë të të njëjtit dokument, subjekti i rivlerësimit në datën 08.04.2019 ka konfirmuar me shkrim tashmë përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, heqjen dorë nga statusi i magjistratit.
4. Me vendimin nr. {***}, datë 24.04.2019, “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të ish-gjyqtarit të Gjykatës së Lartë Aleksandër Muskaj”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit të z. Aleksandër Muskaj, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli.
5. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Aleksandër Muskaj, me vendimin nr. 179, datë 10.07.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 179, datë 10.07.2019, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi:
 1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Aleksandër Muskaj, është ndërprerë.

2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. [...]

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit Aleksandër Muskaj, më datë 26.07.2019, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 179, datë 10.07.2019, vetëm sa i takon pikës 2 të tij, me përmbajtje: *Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*, për shkak se sipas tij ky vendim është marrë në kundërshtim me ligjin.
8. Subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji që, pas shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e tij lidhur me pikën 2 të vendimit të Komisionit nr. 179, datë 10.07.2019, në përfundim të shqyrtimit të vendosë në mënyrë alternative:
 - *Prishjen e kësaj pike të vendimit dhe pushimin e gjyqimit për këtë pjesë ose shfuqizimin e vendimit për këtë pjesë.*
9. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 9.1. Lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendoi se procesi administrativ në Komision është kryer në kundërshtim me parashikimet e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), pasi ai është bazuar në disa akte shkresore, të cilat konsistojnë në korrespondencën e subjektit të rivlerësimit me Komisionin, dhe në aktin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat nuk janë bërë objekt shqyrtimi dhe debati gjyqësor, ku subjekti të dëgjohej dhe të shprehte qëndrimin e tij lidhur me to.
 - 9.2. Subjekti pretendoi gjithashtu se në aspektin procedural, vendimi i Komisionit, sa i takon pikës 2 të tij, është marrë në kundërshtim me nenin 7 të KEDNj-së pasi është aplikuar “një dënim pa ligj”.
 - 9.3. Subjekti pretendoi se vendimi i Komisionit nuk është bazuar në dispozitat procedurale pasi nuk ka pasqyruar në mënyrë të saktë e të renditura kronologjikisht faktet e ndodhura, si dhe nuk ka pasqyruar veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me njoftimin e kryer ndaj Komisionit për mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe fillimin e ushtrimit të aktivitetit privat, për shkak të të cilave duhej të ndërpritej procesi i rivlerësimit.
 - 9.4. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës pasi, referuar fakteve, Komisioni nuk ka qenë para rastit të parashikuar shprehimisht nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon dorëheqje nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Subjekti pretendoi se statusi i magjistratit për të kishte mbaruar me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe jo si pasojë e heqjes dorë nga e drejta për t'u caktuar gjyqtar në nivel gjykate apeli, sikurse në mënyrë të gabuar është shprehur KLGj-ja në vendimin e saj.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Aleksandër Muskaj dhe për të cilin subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, kërkon prishjen ose shfuqizimin e pikës 2 të tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh¹, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 179, datë 10.07.2019, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi, nga ku u konstatua se gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, është cenuar e drejta e subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, në përputhje me parashikimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar

¹ Siç rezulton nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 179, datë 10.07.2019, për rivlerësimin e subjektit Aleksandër Muskaj, i është njoftuar subjektit me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2019, konfirmuar marrja dijeni në datën 11.07.2019, sipas lajmërimarrjes përkatëse. Ndërkohë ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 26.07.2019, protokolluar me nr. {***}, në të njëjtën datë. Në këto kushte, subjekti rezulton të ketë ushtruar ankim në ditën e 15-të të afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, e cila u zhvillua me praninë e subjektit të rivlerësimit.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

13. *Lidhur me shkakun e ankimit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor*, për të cilin subjekti i rivlerësimit pretendoi se procesi administrativ në Komision është kryer në kundërshtim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, pasi ai është kryer mbi bazë dokumentacioni, konkretisht bazuar në korrespondencën e subjektit të rivlerësimit me Komisionin, si dhe duke iu referuar një akti të Këshillit të Lartë Gjyqësor², akte këto të cilat sipas subjektit nuk janë bërë objekt shqyrtimi dhe debati gjyqësor, ku ai të dëgjohej dhe të shprehte qëndrimin e tij lidhur me to, trupi gjykues konstaton sa më poshtë.
14. Referuar procesverbalit të mbledhjes së zhvilluar nga trupi gjykues i Komisionit, më datë 10.07.2019 dhe përmbajtjes së vendimit nr. 179, datë 10.07.2019, çështja e rivlerësimit që i përket subjektit të rivlerësimit Aleksandër Muskaj është shqyrtuar nga Komisioni në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në mungesë të seancës dëgjimore me palën e interesuar, subjektin e rivlerësimit Aleksandër Muskaj. Me vendimin e sipërcituar, Komisioni ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Aleksandër Muskaj, si dhe humbjen e së drejtës së tij për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, duke sjellë në këtë mënyrë, pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin ligjor të subjektit të rivlerësimit.
15. Komisioni, në vendimin e tij nuk është shprehur në asnjë moment lidhur me të drejtën e subjektit për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore apo lidhur me rrethanat të cilat kanë përligjur përjashtimin e tij nga kjo e drejtë, referuar rasteve të përcaktuara shprehimisht në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative, sikundër as në pjesën ku referohet baza ligjore në të cilën mbështetet vendimi i dhënë nga Komisioni, nuk referohet asnjë dispozitë ligjore në këtë drejtim.
16. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, mosmbajtja e seancës dëgjimore nga Komisioni, në kundërshtim me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në mungesë të rasteve përjashtimore të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilave procedura administrative mund të mbyllet pa nevojën e njoftimit të subjektit dhe pa i dhënë mundësinë këtij të fundit për t’u dëgjuar lidhur me çështjen e tij, vlerësohet si mosrespektim nga ana e Komisionit e së drejtës së subjektit për t’u dëgjuar në shqyrtimin e çdo çështjeje që sjell pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin e tij ligjor. Gjithashtu, kjo sjellje procedurale e Komisionit vlerësohet se ka cenuar transparencën e procesit të rivlerësimit, i cili në themelin e tij ka nevojën e rikthimit të besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë.

² Subjekti i referohet këtu vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. {***}, datë 26.04.2019, “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magistratit, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, z. Aleksandër Muskaj”.

17. Për rrjedhojë, në shqyrtim të këtij shkakui të ngritur në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se, bazuar në rrethanat e rastit në fjalë dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjtit, vendimmarrja e Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Aleksandër Muskaj dhe ndalimin e ushtrimit të funksioneve të caktuara në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për periudhën kohore prej 15 vitesh, në mungesë të njoftimit të subjektit dhe pa i dhënë atij të drejtën për t'u dëgjuar lidhur me rezultatin e pritshëm të kësaj procedure, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të cenimit të së drejtës së subjektit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, sipas përcaktimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 të KEDNj-së.
18. Për rrjedhojë të sa më sipër, shkakui i ngritur në ankimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për proces të rregullt nga ana e Komisionit, u gjet i drejtë dhe i bazuar. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues, në zbatim të kompetencave korigjuese lidhur me gabimet procedurale të kryera nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, parashikuar shprehimisht në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 51, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit të rivlerësimit, duke i garantuar atij të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në mënyrë efektive përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, lidhur me të gjitha pretendimet e tij për procesin e rivlerësimit kalimtar, të cilat do t'i kishte dhënë përpara Komisionit, në mënyrë të veçantë lidhur me efektet që passillte në ecurinë e këtij procesi, vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. {***}, datë 24.04.2019, "Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të ish-gjyqtarit të Gjykatës së Lartë Aleksandër Muskaj".
19. *Lidhur me shkakun e ngritur në ankim, se përcaktimi në pikën 2 të vendimit të Komisionit, të ndalimit në ushtrimin e profesionit për 15 vite, përbën shkelje të nenit 7 të KEDNj-së³, duke qenë se sipas subjektit të rivlerësimit, edhe pse jemi në një proces administrativ, në konsideratë të ashpërsisë së këtij sanksioni, ai konsiderohet i natyrës penale⁴, i cili sipas tij është vendosur pa ligj, pasi nuk ka asnjë lidhje mes këtij sanksioni dhe shkeljes së pretenduar të Komisionit për mosushtrimin e së drejtës për t'u caktuar si gjyqtar në nivel apeli.*
20. Në analizë të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues vlerëson se parashikimi i pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës është i zbatueshëm në të gjitha rastet kur subjektet ndodhen në kushtet e parashikuara sipas pikës 1 të këtij neni. Për rrjedhojë, analiza lidhur me vendosjen e ndalimit të emërimit gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjecare, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, kryhet e pandarë nga

³ Neni 7 I KEDNj-së, përcakton:

"1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepër penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara."

⁴ Subjekti referon këtu në kuadër të praktikës së GJEDNj-së vendimin e saj "Engel and Others v. the Netherlands".

analiza lidhur me plotësimin e kushteve të parashikuara në pikën 1 të së njëjtës dispozitë kushtetuese. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, me përcaktimin në pikën 2 të vendimit objekt ankimi të parashikimit të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, ka cenuar nenin 7 të KEDNj-së, si pasojë e vendosjes së një “dënim penal” pa ligj, trupi gjykues në analizë të këtij pretendimi, vlerëson se situata faktike e përcaktuar në pikën 1 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për të cilën pasoja juridike që prodhon vlerësohet nga ana e subjektit të rivlerësimit me “natyrë penale”, nuk përcaktohet nga dispozita kushtetuese si pasojë e ndonjë vepre penale, por zbatohet nga organet e rivlerësimit të përcaktuara në nenin 179/b, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës në kuadër të një procesi administrativ.

21. Kufizimi i përkohshëm i së drejtës për t’u emëruar në pozicionet e sipërcituara, nuk kualifikohet në legjisllacionin e brendshëm dhe të posaçëm për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si një dënim penal, nuk është rrjedhojë e një procesi me natyrë penale, si dhe nuk jepet nga një gjykatë penale. Ky kufizim i përkohshëm i së drejtës të subjekteve të rivlerësimit për t’u emëruar në pozicionet e përcaktuara shprehimisht në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është vlerësuar nga kushtetutëbërësi si pasoja juridike që rrjedh në të gjitha rastet kur subjektet e rivlerësimit, në saje të vullnetit të tyre, humbasin cilësinë subjektive për të qenë pjesë e procesit të rivlerësimit kalimtar dhe ky proces ndërpritet pa një vendim përfundimtar lidhur me rivlerësimin e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se pika 2 e vendimit objekt ankimi, e cila i vendos subjektit të rivlerësimit pasojën juridike të përcaktuar shprehimisht në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, nuk përbën dënim penal dhe, në këtë kuptim, pretendimet e subjektit në raport me cenimin e nenit 7 të KEDNj-së, gjenden të pabazuara nga trupi gjykues.
22. Në përfundim, nga kontrolli i ushtruar ndaj vendimit objekt ankimi të Komisionit edhe në drejtim të pajtueshmërisë me Kushtetutën, Kolegji në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese, referuar këtu edhe arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj V-2/17⁵, arrin në konkluzionin se vendosja nga Komisioni e kufizimit të përkohshëm për subjektin e rivlerësimit për t’u emëruar në pozicionet e sipërcituara, përbën zbatimin e një parashikimi kushtetues të detyrueshëm, në rastin kur rezultuan të plotësuara kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Sa i takon pretendimit lidhur me ashpërsinë e kësaj pasoje juridike që prodhon ndërprerja e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues çmon se pretendime të kësaj natyre nuk mund të jenë objekt i procesit gjyqësor në Kolegji, pasi Kolegji nuk ka asnjë diskrecion vlerësimi në këtë drejtim, për sa kohë bëhet fjalë për një parashikim kushtetues.
23. *Sa i takon shkakut të ankimit se vendimi i Komisionit nuk është bazuar në dispozitat procedurale pasi nuk ka pasqyruar në mënyrë të saktë e të renditura kronologjikisht, faktet e ndodhura, të cilat sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim i referohen momentit të deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, të deklaruar me vendimin nr. {***}, datë 29.06.2017, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, në vijim të sa më sipër, dorëzimit prej tij të detyrës, në datën 31.07.2017, trupi gjykues vlerëson se nga shqyrtimi i pjesës hyrëse të*

⁵ Shih paragrafin 68 të vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

vendimit objekt kontrolli⁶, konstatimi i subjektit të rivlerësimit për referim të pasaktë në aspektin kronologjik dhe atë ligjor, të dy momenteve të sipërcituara, është i saktë. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues vlerëson se ky konstatim nuk mund të ngrihet në nivelin e ndonjë shkaku ankimi që të bëjë të cenusshëm vendimin e Komisionit në drejtim të konkluzionit të arritur prej tij për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, pasi nuk rezultoi që kjo të ketë pasur rol përcaktues për zgjidhjen e çështjes nga ana e Komisionit. Në të njëjtin konkluzion arriti trupi gjykues edhe sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me veprimet procedurale të kryera nga ana e subjektit të rivlerësimit në lidhje me njoftimin që ky i fundit i ka bërë Komisionit lidhur me mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe fillimit të ushtrimit prej tij të aktivitetit privat.

24. *Lidhur me shkaku e ankimit sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës*, pasi sipas tij, referuar fakteve, Komisioni nuk ka qenë para rastit të parashikuar shprehimisht nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon dorëheqje të subjektit të rivlerësimit nga detyra që është duke kryer efektivisht. Subjekti pretendoi se statusi i magjistratit për të kishte mbaruar me mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe jo si pasojë e heqjes dorë nga e drejta për t'u caktuar gjyqtar në nivel apeli, sikurse në mënyrë të gabuar është shprehur KLGj-ja në vendimin e saj. Në këtë kuptim, subjekti pretendoi si të pabazuar në ligj edhe arsyetimin e Komisionit në vendim, sipas të cilit Komisioni ka arritur në përfundimin që subjekti i rivlerësimit vazhdon të gëzojë statusin e magjistratit edhe pas përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
25. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë një analizë të gjatë në ankimin e tij, si dhe në parashitjet para trupit gjykues në seancë gjyqësore publike në Kolegj, mbi momentin e mbarimit të statusit të tij të magjistratit, sipas tij, menjëherë me mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë të sa më sipër, subjekti ka pretenduar se Komisioni duhet të kishte vlerësuar këtë fakt në vendimin e tij si shkaku e duhur ligjor për të vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit (në kuadër të pamundësisë për të përmbushur objektin për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit), dhe jo vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbarimin e statusit të magjistratit, si pasojë e heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel apeli.
26. Në analizë të këtij shkaku ankimi, sa u takon pretendimeve dhe argumenteve të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e momentit të përfundimit të statusit të tij të magjistratit, i cili është i lidhur me shkaku për të cilin është vendosur deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. {***}, datë 24.04.2019, “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të ish-gjyqtarit të Gjykatës së Lartë Aleksandër Muskaj”, si dhe lidhur me kontrollin e bazueshmërisë në ligj të vendimit të sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, trupi gjykues arrin në përfundimin se vlerësimi dhe disponimi mbi këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, referuar parashikimeve të neneve 97, pika 1, germa “a” dhe

⁶ Shih paragrafin 5 të vendimit të Komisionit nr. 179, datë 10.07.2019, në të cilin ky i fundit shprehet: “[...] Në datën 31.07.2017 ai ka dorëzuar detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Në vijim të kësaj procedure është deklaruar mbarimi i mandatit të gjyqtarit në këtë gjykatë me vendimin nr. {***}, datë 29.06.2017, të Gjykatës së Lartë”.

100, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nuk bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

27. Kolegji, në kuadër të shqyrtimit të bazueshmërisë në fakte dhe në ligj të shkakut të ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit, kontrollon vendimmarrjen e Komisionit vetëm në drejtim të përcaktimit të drejtë dhe të plotë të situatës faktike dhe zbatimin e ligjit mbi këtë situatë faktike të provuar gjatë procesit në Komision. Për rrjedhojë, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, rezultoi se Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. {***}prot., datë 25.04.2019, i ka përcjellë Komisionit vendimin nr. {***}, datë 24.04.2019, “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit të ish-gjyqtarit të Gjykatës së Lartë Aleksandër Muskaj”, me të cilin, bazuar në nenet 62 dhe 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur: *Të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, z. Aleksandër Muskaj, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli.* Nga gjykimi në Kolegji, nuk rezultoi që vendimi i sipërcituar i Këshillit të Lartë Gjyqësor të jetë ankimuar nga subjekti i rivlerësimit në gjykatën kompetente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, duke i dhënë kësaj vendimmarrjeje efektet e një akti të formës së prerë sa i takon urdhërimit përkatës.
28. Komisioni, në vendimin e tij lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit të subjektit Aleksandër Muskaj, ka arsyetuar: *Komisioni u njoh me [...] si dhe me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për mbarimin e statusit të magjistratit në datën 24.4.2019, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, z. Aleksandër Muskaj. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli dhe nga statusi i magjistratit. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti humb të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjecare, sipas parashikimeve të pikës 2 të Aneksit të Kushtetutës.*
29. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se, me mbarimin e statusit të magjistratit, subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e tij si subjekt rivlerësimi *ex officio*, fakt ky i cili referuar vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. {***}, datë 24.04.2019, ka ardhur si pasojë e vullnetit të subjektit të rivlerësimit për të mos vijuar të gëzojë këtë status sipas parashikimeve të nenit 62 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nëpërmjet vullnetit për heqjen dorë nga caktimi në një pozicion në nivel gjykate apeli. Në kushtet kur statusi i magjistratit, referuar vendimit të Këshillit, ka mbaruar si pasojë e vullnetit të subjektit të rivlerësimit (për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli) Komisioni me të drejtë ka zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës mbi këtë situatë faktike dhe, në përfundim, ka vendosur të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e ndalimit të parashikuar në pikën 2 të së njëjtës dispozite kushtetuese.
30. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, në analizë të legjislacionit të

zbatueshëm, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 179, datë 10.07.2019, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit z. Aleksandër Muskaj dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit objekt shqyrtimi, është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 179, datë 10.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Aleksandër Muskaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 17.12.2020, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi